



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN**  
**REKTORATI**

Nr. 1114/2 prot.

Elbasan, më 14.10.2016

**UDHËZIM**

**Nr.3, datë 14.10.2016**

**PËR**  
**PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE FITUES NË**  
**PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT NË UNIVERSITETIN**  
**“ALEKSANDER XHUVANI” ELBASAN, PËR VITIN 2016-2017**

Në mbështetje të nenit 25 pika 7, 8 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Kreu IV/2 të Udhëzimit të MAS nr.13, datë 22.07.2016, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 24/1 datë 12.10.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2016-2017, Vendimin e Senatit Akademik nr. 1, datë 04.02.2016 “Për miratimin e kritereve shtesë për pranimin në programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”; Vendimin e KADM nr.8, datë 08.09.2016 “Mbi vendosjen e tarifës së regjistrimit në “Bachelor” dhe “MSH e “MP” për vitin akademik 2016-2017”;

**U D H Ë Z O J:**

1. Aplikimet për programet e ciklit të dytë me kohë të plotë për të gjithë kandidatët vijnë deri në datën 20 tetor 2016, në sekretariatë mësimore të Fakulteteve nga ora 8<sup>00</sup>-16<sup>00</sup>.
2. Brenda datës 24 tetor 2016, të shpallen listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, në faqet e web të UE-së të ndarë sipas programeve të studimit të renditur sipas rendit zbritës.
3. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues zhvillohet nga data 24 tetor 2016 deri në datën 28 tetor 2016 pranë sekretarive mësimore përkatëse.
4. Kandidatët do të dorëzojnë personalisht, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4 të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin ose në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN**  
**REKTORATI**

---

kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.

- Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku kanë përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i shtetit së bashku me listën e notave.

Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë shtetit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga MAS;

- Formulari i aplikimit (sipas formatit të shtojcës nr 7, bashkëlidhur këtij Udhëzimi);
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
  - Dy fotografi personale;
  - Mandat pagese e tarifës së regjistrimit prej 2500 lekesh.
5. Brenda datës 31 tetor 2016 të shpallen listat e kandidatëve të regjistruar , në mjediset e njësive kryesore përkatëse, në faqen e web-it të UE-së të ndarë sipas programeve të studimit.
  6. Sekretaritetë mësimore, të mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit për atë vit akademik.
  7. Ngarkohen Zv/Rektori, Dekanët e Fakulteteve, Sekretaritetë mësimore, Drejtoria e Standardeve dhe Kurrikulave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**

**Prof.Dr. Skender TOPI**